



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Bordi i Administrimit

Nr. 1783 prot.

Shkodër, më 08.05.2026

V E N D I M

Nr. 147, datë 08.05.2026

"PËR MIRATIMIN E TARIFËS DHE MASËS SË PAGESËS SË PEDAGOGËVE PËR ZHVILLIMIN E KURSEVE TË GJUHËS SHQIPE SI DHE CAKTIMIN E NUMRIT TË PJESËMARRËSVE NË KURS"

Në mbështetje të Ligjit të AL me nr.80/2015 "Per Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3 pika 4, germa α ; Të Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", neni 38 pika 3; neni 17, pika 6 germa nj; me Vendim të SA-së nr.130 datë 23.04.2026, Bordi i Administrimit me vendim qarkullues të datës 07.05.2026,

Vendosi:

1. Miratimin e tarifës prej 5 000 lekësh për regjistrim të të interesuarve për "Certifikimin e njohurive mbi gjuhën shqipe"(në rast njohjeje të kësaj gjuhe), si dëshmi institucionale.
2. Miratimin e pagesës së pedagogëve për zhvillimin e kurseve të gjuhës shqipe, në masën 70% të të ardhurave nga çdo kurs dhe 30% për shpenzimet institucionale.
3. Miratimin e pagesës së pedagogëve për përfshirjen në komisione certifikimi të njohurive mbi gjuhën shqipe (pa nevojë kursi), në masën 70% të të ardhurave për pedagogët dhe 30% për institucionin.
4. Miratimin e zhvillimit të kurseve të gjuhës shqipe me jo më shumë se 5 pjesëmarrës."
5. Ky vendim i përcillet administratorit të USH-së.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Prof. Asoc. Dr. Adrian Leka

